

RAPORT LIKUIDIMI

I mbajtur sot më 08.06.2022 pranë shoqërisë "THE TEMPLE" shoqëri në likuidim nga likuidatori i saj Rajmonda Ruci.

Shoqëria "THE TEMPLE" shoqëri në likuidim është themeluar në datën 21/02/2017 sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 22/02/2017. Kapitali i regjistruar i saj është 100.000 leke i ndare në 2 kuota pjesë me vlerë nominale 100, lekë për çdo pjesë, të cilat zotërohen në 50 % Adem Maha, 50 % Anila MAHO.

Në datën 21 Shkurt 2022 është regjistruar në QKB vendimi i ortakeve për prishjen e shoqërisë, kalimin e saj në likuidim dhe emërimin e Rajmonda Ruçi në detyrën e likuidatorit.

Baza ligjore për likuidimin e shoqërisë:

1. Ligji 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", pjesa e VI.
2. Ligji 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", seksioni V.

Mbas marrjes së detyrës dhe disa verifikimeve të llogarive, bëra lajmërimin e kreditorëve përkatësisht në datat 25/02/2022 dhe në datën 25/03/2022. Ky lajmërim u bë nëpërmjet faqes së internetit të QKB-së. U konstatua se kjo shoqëri që nga krijimi i saj nuk ka kryer asnjë lloj aktiviteti. Ajo nuk ka plotësuar asnjë faturë faturë shitje. Aktiviteti i kësaj shoqërie ka vazhduar përveçse 3 muaj kalendarik. U bënë verifikimet përkatëse në çdo institucion, si në Drejtorinë e Tatimeve Tirane, ashtu dhe në Bashkinë Tirane.

Pas kësaj, filloi puna për bilancin e mbylljes ku u kryen këto veprime kontabile:

1. U konstatua se shoqëria nuk ka as detyrime dhe as të drejta në bilancin e saj, asnjë detyrim nga klientet dhe asnjë detyrim dhe për postin furnitore. Meqenëse nga njoftimet e bera në QKB, debitor-kreditor një pjesë e ketyre nuk ngriten pretendime në lidhje me këto detyrime. Në bilancin e saj shoqëria ka të drejta në zërin TVSH të drejta në shumën 662 608 leke, edhe në verifikimin në sistemin e-filling u konstatua kjo shifër e TVSh, në vlerën 632 617 leke. Meqenëse shoqëria në bilancin e vet ka dhe gjendje inventari në shumën 2 507 257 leke, por në të vertet këto mallra janë falur ose përdorur nga vet ortakët e shoqërisë. Duke parë këtë situatë unë si likuidator mendova të bëj një autofaturë ku e pasqyrova si në shitje dhe në blerje. Efekti i këtij veprimi në këtë rast është (0) zero. Nga sa më sipër kemi veprimet si më poshtë;

2. **Debi :** Llogaria 456 në formë dividendi 3 008 708 leke

Kredi: llog 705 shitje mallrash 2 507 257 lekë.

Kredi: llogaria 4456 Tvsh në shitje 501 451 lekë

Diferenca 4455 Tvsh 161 567 leke, drejtoria e tatimeve të bëj sistemitet përkatëse në sistemin e-filling. **Thëksoj se shoqëria nuk ka kryer asnjë transaksion shitje.**

3. Nga kontrolli i konfirmave bankare, u konstatua se gjendja e likuiditeteve ishte zero lekë sepse e ka tërhequr ortakun e vetëm. Në këto kushte, bëjmë mbylljen e gjendjes në bankë që figuron në bilancin e dorëzuar në tatime. Duke e konsideruar si një tërheqje të fitimeve që figurojnë në bilanc:

Debi: llog 109 "Fitime të mbartura" 186 506 lekë.

Kredi: llog 512 Banka 186 506 lekë.

4. U kontrollua gjendja reale e situatës në tatime dhe figuroi si më poshtë:

- **Kredi** 447 Gjopa për deklaram me vonese në shumën 30 000 lekë.
- **Debi** 456 ortakun Divident 30 000 leke

Ky detyrim u shlye dhe u zerua nga ortakut ne shumen 30,000 lekë nga llogaria e vet vetjake.

Dhe Detyrimet vendore ndaj Bashkise Tirane ne shumen 12,265.4 leke,u shlyen nga llogaria personale e ortakut.

Shoqeria ne aktivin e saj ka dhe nje parapagim per furnizime ne shumen 7 101 318 leke.Kete shume edhe pse eshte bere parapagim per mallra, keto mallra nuk u sollen ndonjehere, si rrjedhoje kjo eshte nje humbje per shoqerine "THE TEMPLE".Por per efekt mbylle bilanci bejme veprimin si me poshte.

Debi: 456 ortakut Divident, 7 101 318 lekë.

Kredi: 4091 Tatim fitimi 7 101 3186 lekë.

Në bilancin e mbylljes, që është edhe përfundimi i punës për likuidimin e shoqërisë "THE TEMPLE" shoqëri në likuidim e sipër, paraqitet gjëndja si më poshtë:

1. Shoqëria sipas bilancit të mbylljes deri më 06.06.2022 nuk ka gjëndje aktive afatgjata materiale ose jomateriale ne vleren 0 (zero) leke
2. Prandaj persa me lart bejme veprimet rregulluese perkatese, meqenese ne bilancin e mbylljes AQT, si ne te ardhura dhe ne shpenzime, efekti eshte zero.
3. Shoqëria "THE TEMPLE" shoqëri në likuidim e sipër, ka në bilancin e saj aktive qarkulluese në formën e inventarit dhe në proces por nga ana ime u gjykua per berje e "autofatures".
4. Shoqëria "THE TEMPLE" shoqëri në likuidim e sipër, në pasivin e bilancit të saj të mbylljes ka vetëm vlera të kapitalit si më poshtë:
 - **Debi:** 101 Kapitali nënshkruar 100 000 lekë.
 - **Debi:** 108 Fitimet e mbartura - 4 368 260 lekë.
 - **Debi:** 109 Fitimet e ushtrimit - 30 000 lekë.
 - **Kredi** 456 Ortaku Divident - 4 298 260 lekë.
 - Pas ketij veprimi rregullues llogarite e kapitalit zerohen.Keshtu qe kemi si me poshte;
 - **Debi:** 101 Kapitali nënshkruar 0 lekë.
 - **Debi:** 108 Fitimet e mbartura 0 lekë.
 - **Debi:** 109 Fitimet e ushtrimit 0 lekë.
 - **Ne zerin e pasivit ne Bilancin e mbylljes jane dhe keto zera :**
 - **Debi** 421 paga ne shumen 697 931 leke
 - **Debi** 455 ortakut 11 049 720 leke
 - **Kredi** 456 ortakut llogaria personale 11 747 651 leke

Mbas ketyre rregjistrimeve të gjitha llogaritë e shoqërisë do të rezultojnë të mbyllura e për rrjedhojë shoqëria nuk funksionon më:

Mbetja e aktivit të bilancit (0) zero

Mbetja e pasivit të bilancit (0) zero

Që kjo mbyllje e shoqërisë të ketë fuqi juridike, do të depozitojmë në QKB dokumentacionin ligjor të mbylljes së likuidimit sikurse janë:


- Vendimi i ortakut të vetëm për mbylljen e shoqërisë dhe miratimin e raportit të likuidatorit.
- Raportin e likuidatorit.
- Bilancin e çeljes së likuidimit.
- Bilancin e mbylljes së likuidimit.

Thelosi se pavarësisht mbylljes në QKB, sipas nenit 53 të ligjit 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" shoqëria edhe e çregjistruar, përgjigjet për detyrimet e mbetura ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shoqëria nuk ka përgjegjësi për deklarime tatimore sepse ka kaluar me status pasiv qysh më 01.02.2020.

Nëse sa më lart, unë jap opinionin tim se shoqëria "THE TEMPLE" shoqëri në likuidim e sipër gjatë punës për mbylljen e likuidimit, ka zbatuar rregullisht kërkesat e ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare".

LIKUIDATORI

Rajmonda RUÇI

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Rajmonda Ruçi', with a long, sweeping flourish extending downwards and to the right.